REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 48/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	NënKryetar
Vima Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:	Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për proçedurën e prokurimit *"Kërkesë për Propozim"*, me Nr. *REF- 43803-11-18-2019*, me objekt "*Blerje Peshore Elektronike*", me fond limit 3,175,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 19.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.
Ankimues:	"Luar Bros" shpk Adresa: Blv "Gergj Fishta", Qëndra Alpas, Kati II, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor	Posta Shqiptare sh.a. Adresa: Rruga "Reshit Collaku", Nr. 4, Tiranë.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.11.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *"Kërkesë për Propozim",* me Nr. *REF- 43803-11-18-2019*, me objekt "*Blerje Peshore Elektronike*", me fond limit 3,175,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 19.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Në datën 25.11.2019, operatori ekonomik "*Luar Bros*" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të proçedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

Parashtrime:

Ne si OE jemi njoftuar nepermjet sistemit elektronik te prokurimit per njoftimin e kontrates suaj me objekt "Blerje peshore". Ne si OE qe operojme me produktet e kerkuara nga AK, duke qene se jemi te interesuar dhe kerkojme te marrim pjese ne kete procedure prokurimi konstatojme disa parregullsi ne hartimin e kritereve te vecanta per kualifikim si dhe ne hartimin e specifikimeve teknike. Bazuar ne nenin 62 e vijues te LPP-se si OE qe ka interes te marre pjese ne procedurat e prokurimit ne legjitimohemi te paraqesim kete ankese,

nderkohe "ratione temporis", afati per paraqitjen e ankeses eshte brenda periudhes 7 ditore nga momenti i publikimit te njoftimit te DST ne SPE.

Parashtrime te faktit
Ne Kriteret e vecanta per kualifikim jane percaktuar nga njesia e Prokurimit, te AK keto kerkesa:

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim nga firma prodhuese ose akt rnarreveshje bashkepunirni ose leter angazhimi me firmen prodhuese per mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi (distributor duhet te vertetoje se eshte autorizuar nga prodhuesi);

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese Certifikate ISO 9001 - 2015 ose ekuivalente me te (Certifikata duhet te jete e leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akrediruese te njohura nga Republika e Shqiperise);

2.2.4. Operatori Ekonomik duhet te paraqese per te gjithe artikujt e kerkuar :

- *Deklaratat e Konformitetit EC/ .*
- *Certifikatat CE ose ekuivalente me te kur jane te aplikueshme sipas direktivave te Keshillit Evropian;*

2.2.5. Operatori Ekonomik duhet te paraqese Katalog prodhuesi te mallit qe ofrohet, te vulosur nga operatori ekonomik kur te jete percaktuar malli qe ofrohet, si dhe te jete i perkthyer dhe noterizuar ne gjuhen shqipe;

2.2.6. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklaraten e garancise per mallin qe ofron, ne te cilen te jene percaktuar dhe pershkruar qarte te gjitha termat dhe kushtet e garancise teknike qe ai mbulon, si dhe periudha e garancise teknike do te jete 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim;

2.2.7. Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te marre persiper identifikimin dhe riparimin e cdo defekti te shfaqur nga pajisjet per vitin e mbulimit me garanci sipas specifikimeve teknike;

2.2.8. Operatori Ekonomik duhet te paraqese test raportet ose certifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga organizmat nderkombetare te njohur nga Republika e Shgiperise dhe duhet te plotesoje rregullat teknike per instrumentet mates qe futen ne Republiken e Shqiperise. Te kete shenjen CE, miratimin e tipit si dhe te kete verifikimin fillestar.

2.2.9. Operatori Ekonomik duhet te paraqese deklarate per origjinen e mallit (kompanite prodhuese, vendet e prodhimit).

2.2.10. Ne oren e percaktuar ne njoftimin e kontrates per hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin dorazi, perpara Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO), mostra (kampione), te 1 (nje) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (nje) peshoreje elektronike 50 kg, te cilat duhet te jene sipas te giitha specifikimeve teknike te kerkuara. Mosparaqitja e mostrave ne afatin e percaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike eshte kusht per skualifikim.

Te gjithe dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

Gjithashtu ne specifikimet teknike jane percaktuar te dhenat/kerkesat e meposhtme:

Peshore Elektronike 5 Kg

***Tipi:** Peshore tavoline digjitale, të përshtatshme për letra, paketa dhe koliposta dhe të jetë e thjeshtë në funksionim, të ketë të integruara aplikime me dy butona;*
***Përmasat e pllakës së peshimit:** 250mm – 300mm X 200mm – 250mm;*
***Pllaka e peshimit**: Pllaka e peshimit të jetë metalike dhe e lëvizshme për pastrim;*
***Kapaciteti:** deri në 5 Kg;*
***Gabimi maksimal i lejuar:**+-2gr;*
***Njësite matëse:** gram, kilogram;*
***Ushqimi:** Të jetë i pajisur me kabllo të ushqimit me tension 220V/50Hz sistem evropian dhe sistem funksionimi me bateri. Funksionim dhe me bateri, të cilat duhet të jenë të karikueshme dhe të mbajnë peshoren në punë ≥12 orë;*
***Ndërfaqet e komunikimit:** RS232 Standard ose USB 1.1/2.0. Të jenë të përfshira në paketim kabllot lidhëse përkatës USB 1.1/2.0 ose serial RS232 të cilat transferojnë informacionin e peshës së matur automatikisht në PC nëpërmjet protokollit SERIAL në rastin RS232 ose emulim të portës seriale në rastin e USB1.1/2.0;*
***Sistemi Operativ**: Kompatibël me të gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri në Windows 10;*
***Kalibrimi:** Kalibrim të paktën në një pike dhe funksion auto-zerimi;*
***Ekrani:** Të shfaqi peshën në kohë reale dhe ekrani të jetë i tipit LCD/LED. Numrat ne ekran jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distanca;*

***Stabiliteti i leximit të peshimit**: Jo më shumë se 3 sek;*
***Garancia:** Kontraktuesi duhet të ofrojë garanci për 1 vit;*
Kontraktuesi te paraqesë Certifikate kalibrimi ose Test Raport;
***Manuali përdorimit:** Përfshirë në paketim.*

Peshore Elektronike 50Kg

***Tipi:** Peshore digjitale, të përshtatshme për thasë, koliposta mbi 5kg apo objekte të tjera;*

Karakteristika e peshores: *Peshorja duhet të jetë e lëvizshme;*
Përmasat e pllakës së peshimit*: 300mm – 400mm X 300mm – 400mm;*
Përmasat e indikatorit*: 200mm – 220 mm X 100mm – 150mm X 50 – 80mm;*
Materiali i pllakës së peshimit*: Metalike;*
Kapaciteti*: deri ne 50 Kg;*
Gabimi maksimal i lejuar*:+-20g;*
Linearitet*: +-40g;*
Njësite matëse*: gram, kilogram;*
Ushqimi: *Të jetë i pajisur me kabllo të ushqimit me tension 220V/50Hz sistem evropian dhe sistem funksionimi me bateri. Funksionim dhe me bateri, të cilat duhet të jenë të karikueshme dhe të mbajnë peshoren në punë ≥ 60 orë;*
Ndërfaqet e komunikimit*: RS232 Standard ose USB 1.1/2.0. Të jenë të përfshira ne paketim kabllot lidhëse përkatës USB 1.1/2.0 ose Serial RS232 të cilat transferojnë informacionin e peshës se matur automatikisht në PC nëpërmjet protokollit SERIAL ne rastin RS232 ose emulim te portës seriale në rastin e USB 1.1/2.0;*
Sistemi Operativ*: Kompatibël me të gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri në Windows 10;*
Kalibrimi*: Kalibrim të paktën në një pike dhe funksion auto-zerimi;*
Ekrani*: Të shfaqi peshën në kohë reale dhe ekrani të jetë i tipit LCD/LED. Numrat ne ekran jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distanca;*
Garanci*a: Kontraktuesi duhet të ofrojë garanci për 1 vit;*
Kontraktuesi te paraqesë Certifikate kalibrimi ose Test Raport;
Manuali përdorimit*: Përfshirë në paketim*

Shenim: te gjitha fjalitet e nenvijezuara jane ato qe kontestohen.

Neni 46 i LPP-se percakton se:

a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata;

b) aftesia teknike operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikime te nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;

2. Autoriteti kontraktor mund te kerkoje edhe certifikata, te leshuara nga organe te pavarura qe vertetojne pajtueshmerine e kandidatit ose te ofertuesit me standarde te kerkuara te cilesise perfshire edhe standardet per menaxhimin e mjedisit.

3. Kerkesat per kualifikim duhet te hartohen ne menyre te tille qe te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem dhe ne cdo rast te jene sipas percaktimeve ne rregullat e prokurimit publik.

Ndersa neni 27/3 i VKM nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregulla vete prokurimit publik" i ndryshuar percakton se:

Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve.

6. Autoriteti kontraktor mund t'u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, 30 (tridhjete) dite pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit; dhe/ose b) deshmine e origjinalitetit te mostrave, pershkrimin dhe/ose fotografite apo katalogjet teknike; dhe/ose c) deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, te leshuara nga institucione te autorizuara, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

Neni 23 i LPP-se percakton rregullin e detyrueshem per AK:

1. Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshe me te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personat me aftesite kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te njejte per te gjithe kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurirnin publik.

Neni 27 pika 1 e VKM nr. 914 percakton se:

1. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP-se dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara.

Neni 20 i LPP-se

Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter, kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre.

Neni 8 i Ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 "Per tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut te produkteve jo ushqimore".

"Kur legjislacioni perkates parashikon nje deklarim nga prodhuesi se ai ka demonstruar permbushjen e kerkesave per nje produkt, prodhuesi harton nje deklarate te vetme EC te konformitetit per te gjitha aktet ligjore apo nenligjore te zbatueshrne ndaj produktit, perfshire dhe proceduren e vleresimit te konformitetit, sipas moduleve perkatese". Kjo deklarate konformiteti leshohet nen pergjegjesine e vetme te prodhuesit ose, sipas rastit, instaluesit.

Neni 9 parashikon se;

Markimi CE i konformitetit vendoset vetem nga prodhuesi ose perfaqesuesi i tij i autorizuar.

2. Markimi CE i konformitetit fiksohet ne produkt perpara vendosjes se tij ne treg. Ai mund te shoqerohet nga nje piktogram ose ndonje tregues per nje perdorim ose rrezik te vecante.

3. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetem ne produktet, per te cilat eshte parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike te zbatueshme dhe nuk duhet te vendoset ne produkte te tjera.

Neni 12

2. Perpara vendosjes se produktit ne treg, importuesi siguron se:

b) produkti mban markimin e konformitetit te kerkuar ose markime te tjera dhe shoqerohet nga dokumentacioni i kerkuar;

Neni 13

Perpara berjes se disponueshme te nje produkti ne treg, shperndaresi verifikon qe:

a) produkti mban markimin e kerkuar te konformitetit;

b) produkti eshte i shoqeruar me dokumentacionin e kerkuar dhe udhezimet e informacionin per sigurine ne gjuhen shqipe, lehtesisht te kuptueshme nga konsumatori ose perdoruesi i fundit;

c) prodhuesi dhe importuesi kane plotesuar kerkesat, ne perputhje me nenet 10 pikat 5 e 6 dhe 12 pika 3 te ketij ligji.

Ligji Nr.9875, date 14.2.2008, ndryshuar, "Per Metrologjine", Neni 15, pika 2.

"Kalibrimi i etaloneve te matjeve dhe instrumenteve matese kryhet ne laboratoret e kalibrimit, me kerkesen e perdoruesit".

Neni 18, pika 2 dhe 3

2. "Instrumentet matese ligjerisht te kontrolluara, qe nuk jane objekt i markimit CE, ashtu si dhe perberesit e tyre, pajisjet shtese dhe pajisjet ndihmese, i nenshtrohen kontrollit metrologjik, qe kryhet nepermjet miratimit te tipit, verifikimit fillestar dhe pasardhes te instrumenteve matese,

3. Perjashtimisht nga pika 2 e ketij neni, instrumentet mates objekt te markimit CE nuk i nenshtrohen miratimit te tipit dhe verifikimit fillestar, por vetem verifikimeve pasardhese.

Neni 25

Instrumentet matese, qe jane me tip te miratuar, i nenshtrohen verifikimit fillestar, vetem nese eshte pershkruar ndryshe.

2. Verifikimi fillestar i instrumentit mates ligjerisht te kontrolluar eshte pergjegjesi e fumitorit. Verifikimi fillestar ka te beje me kontrollin e instrumentit mates te ri ose te riparuar dhe vertetimin e perputhshmerise se tij me tipin e miratuar. Ky instrument mates ligjerisht i kontrolluar certifikohet me shenjen e verifikimit fillestar.

Neni 27

Vendi i verifikimit eshte vendi jashte kushteve te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise ose te nje personi juridik te autorizuar, ku keto te fundit kryejne verifikimin e nje tipi te vecante instrumenti mates ligjerisht te kontrolluar, duke perdorur pajisjet e pershkruara, qe i perkasin kesaj drejtorie, personit juridik te autorizuar, perdoruesit te instrumentit mates apo sherbimit te autorizuar.

Neni 63

Sherbimet metrologjike qe kryhen nga Drejtoria e Pergjithshme e metrologjise, perfshire kalibrimin, certifikimin e materialeve referuese, njohjen/miratimin e tipit, verifikimin fillestar, pasardhes dhe jashte radhe te instrumenteve matese, miratimin dhe monitorimin e sistemit te kontrollit sasior te prodhuesve te parapaketimeve dhe te shisheve si ene matese, ekspertizen metrologjike, si dhe trajnimet e ofruara, kryhen kundrejt tarifave te miratuara.

III. Argumenta dhe analiza ligjore

Ne lidhje me kriterin 2.2.4

Operatori Ekonomik duhet te paraqese per te gjithe artikujt e kerkuar Deklaratat e Konformitetit EC/ Certifikatat CE ose ekuivalente me te kur jane te aplikueshme sipas direktivave te Keshillit Evropian.

Kjo kerkese bie ndesh me nenin 20 te LPP-se kjo kerkese eshte diskriminuese per arsye se legjislacioni horizontal dhe ai sectorial kane parashikuar rregullat per prodhimin dhe tregtimin e instrumenteve mates. Bazuar edhe ne KPK te DST, nuk ka asnje kufizim ne lidhje me origjinen e produkteve. Kjo kerkese e harmonizuar me kerkesat e meposhtme e ben kushtin qe mallrat te jene prodhuar brenda nje indikacioni te caktuar gjeografik (shih legjislacionin per pronesine industriale), pra nje kufizim edhe per vete produktet shqiptare duke diskriminuar produktet ne baze te origjines. Kujtojme se certifikatat CE jane per indikacionin e tregut te unionit evropian (evropa perendimore) dhe kufizimi bie ndesh me vete kushtet rregullatore te percaktuara ne legjislacionin shqiptar qe lejon tregtimin e instrumenteve te prodhuar edhe ne vende te tjera si ne ballkanin perendimor, azi, amerike, etj.

Ky kusht teknik bie ndesh edhe me nenin 23 te LPP-se qe per nga rendesia e kerkesave teknike, pikesepari i referohet fillimisht standarteve kombetare e ne mungese te tyre jane standartet nderkombetare dhe ne asnje moment nuk ka reference per standarte me indikacione gjeografike te caktuara, qe perbejne bazen e njohjes se origjines se nje produkti, pasi jemi ne kushtet e kufizimit te tregut, konkurrueshmerise dhe diskriminimin mbi baza etnie te ofertuesve/ prodhuesve te tjere. Per me teper ne raport me kerkesat e meposhtme kjo kerkese eshte kufizim hinke, pasi filtron ne kolone kryesore gjithe kerkesat e percaktuara meposhte. Per me teper, rregullatori lejon edhe produktet me markimin CE, si dhe verifikimin e tyre. Persa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri si dispropocional, dhe diskriminues.

Ne lidhje me kriterin 2.2.8

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet te paraqese test raportet ose ce1tifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike, te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga organizmat nderkombetare te njohur nga Republika e Shqiperise dhe duhet te plotesoj rregullat teknike per instrumentet mates qe futen ne Republiken e Shqiperise. Te kete shenjen CE, miratimin e tipit si dhe te kete verifikimin fillestar.

Edhe kjo kerkese referuar dispozitave ligjore te sipercituara bie ndesh pasi legjislacioni lejon dorezimin e ketyre dokumentave ne menyre jo shteruese. Pra, nese nje produkt eshte objekt i markimit CE, nuk i nenshtrohet procedures se miratimin e tipit dhe verifikimin fillestar. Duke qene se legjislacioni lejon miratimin e tipit dhe verifikimin fillestar vetem per ato produkte qe nuk jane objekt i markimit CE, atehere nuk ka arsye te kerkohet si document plotesues. Pra kerkojme vendosjen e lidhezes ose dhe riformulimin e kriterit, "Te kete shenjen CE ose (/) te kete".

Ne lidhje me kriterin 2.2.10;

2.2.10 Ne oren e percaktuar ne njoftimin e kontrates per hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet te paragesin dorazi, perpara Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO), ***mostra (kampione)****, te 1 (nje) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (nje) peshoreje elektronike 50kg, te cilat duhet te jene* ***sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara****. Mos paraqitja e mostrave ne afatin e percaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike eshte kusht per skualifikim. Ndersa ne specifkimet teknike jane kerkuar nder te tjera: Kontraktuesi te paraqese Certifikate kalibrimi ose Test Raport:*

Kjo kerkese eshte tejet disproporcionale pasi i bie qe OE te dorezoje certifikatat e kalibrimit ose test raportet per cdo produkt (pra per 160 cope). Per me teper certifikata e kalibrimit bazuar ne nenin 63 te ligjit per Metroliogjkine kane nje pagese te konsiderueshme, dhe bazuar ne udhezimet perkatese te ministres pergjegjese, certifikata e kalibrimit per peshoret leshohet ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me kerkese te pales blerese. Pra nga menyra e vendosjes se kerkeses nuk mjafton dokumentacioni per mostren, por per te gjithe artikujt, duke qene se referenca e kriterit eshte bere tek specifkimet teknike pa e dalluar ate si kriter i posacem per mostren e kerkuar. Madje, sipas akteve te sipercituara dhe duke ditur qe AK do ti perdor keto paisje per transaksion tregtar duhet te kerkoje vetem sherbimin e verifikimit, i cili eshte nje detyrim ligjor, dhe shume pak me i kushtueshem se procesi i kalibrimit.

Kerkojme heqjen e fjalise: ***"te cilat duhet te jene sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara" dhe te saktesohet specifkimi vetem per mostren e kerkuar ne lidhje me me certifikaten e kalibrimit, ose test raportin ose certifikaten e verifikimit****".*

Ne lidhje me specifkimet teknike, verejme se ne emertimin e produktit peshore 5 kg dhe peshore 50 kg, ka percaktuar si kapacitet maksimal deri ne 5kg dhe deri ne 50kg. Ky kriter nuk ka marre fare parasysh kerkesat per percaktimin e vleres minimal dhe asaj maksimal, sipas VKM Nr. 631/25.09.2019 "Per miratimin e rregullit Teknik per instrumentet e peshimit jo automatic dhe percaktimin e listes se standarteve te harmonizuara". Sipas kesaj llogjike te vendosur nga AK i bie te refuzohet nje peshore qe mat 6 kg dhe te pranohet nje peshore qe mat l kg, pavarsisht emertimit te peshores. Specifkimet teknike referuar nenit 23 duhet te garantojne trajtim te barabarte te OE. Nga menyra e vendosjes se kesaj kerkese, pa nxjerre ne pah qarte peshen maksimale qe duhet te mase peshorja per secilin model te kerkuar, ne kundershtim me VKM nr. 631/25.09.2019, e ben kete kerkese keq orientuese per OE, ne rastin me te mire, dhe favorizuese per OE e preferuar nga AK ne zbatim te kontrates duke cenuar rregullat e gares se ndershme ndermjet OE. Ne referim te dispozitave ligjore te sipercituara, Kodit Civil, Kodit te Procedurave Administrative ne lidhje me specifkimet teknike kerkojme:

Kapaciteti: *deri ne 5 kg dhe 50 kg; te percaktohet vlera minimale dhe ajo maksimale e kapacitetit ne menyre qe te nxjerre ne pah sasine matese te peshores se ofertuar nga OE.*

Sistemi Operativ: *Kompatibel me te gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri ne Windows 10; kerkojme qe ky kriter te hiqet per versionin Windows XP, duke qene se suporti per kete version ka mbaruar prej vitesh dhe nuk eshte me ne perdorim vec nese AK kerkon te marre produkte te vjetra dhe jo te reja.*

Kontraktuesi te paraqese Certifikate kalibrimi ose Test Raport*; ne lidhje me kete kriter sic e parashtruam me siper duke qene se certifikata e kalibrimit behet ne vendin e ushtrimit te aktivitetit nga bleresi te hiqet dhe te lejohet certifikata e verifkimit fillestar pa permendur faktin se certifikata e kalibrimit perben nje kosto te shtuar te padrejte per OE pasi referuar nenit 63 te LPM ka nje kosto shume te larte. Dhe kufizon konkurrencen.*

II.2.1. Në datën 03.12.2019, me shkresën nr. 2999/8 prot, operatori ekonomik "*Luar Bros*" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor si më poshtë vijonë:

Ne pergjigje te ankeses tuaj, ardhur prane "Postes Shqiptare" sh.a., me date 25.11.2019, me Nr. 2999/3 Prot., ne lidhje me kriteret kualifikuese te procedures se prokurimit me objekt "Blerje peshore elektronike" me fond limit 3.175.000 (tre milion e njeqind e shtatedhjete e pese mije) Leke pa T.V.SH.

Ju sqarojme si me poshte vijon:

• Ne lidhje me pretendimin e ngritur mbi piken 2.2.4 te "Kriteret e Vecanta per Kualifikim" ku citohet se:

2.3.4 "Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese per te gjithe artikujt e kerkuar Deklaratat e Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente me te kur jane te aplikueshme sipas direktivave te Keshillit Europian".

Sqarojme se Certifikata "CE" dhe Deklarata e Konformitetit sipas direktivave te Keshillit Europian jane dokumente standarte qe kerkohen ne te gjitha procedurat e prokurimit qe kane si objekt mall apo sherbim, pasi kjo kerkese vjen ne perputhje me V.K.M.-ne Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar. Konkretisht ne nenin 30 nenvizohet se: "'Autoriteti Kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje Organ i Vleresimit te Korformitetit, i akredituar nga Organizmi Kombetar i Akreditimit ose Organizma Nderkombetare Akredites, te njohur nga Republika e Shqiperise. Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit".

Ne ankesen drejtuar Autoritetit Kontraktor ju pretendoni se: "...kjo kerkese eshte kufizim hinke, pasi filtron ne kolone kryesore gjithe kerkesat e percaktuara me poshte. Per me teper, rregullatori lejon edhe produktet me markimin CE, si dhe verifikimin e tyre. Persa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri si dispropocional dhe diskriminues".

Deklarata e konformitetit ne nje kuader te pergjithshem perben nje dokument qe leshohet nga prodhuesi, i cili gezon te drejten te bej transformimin apo modifikimin duke shtuar aksesore specifik per mjetet qe prodhohen nga nje operator i autorizuar/certifikuar nga vete prodhuesi. Ne asnje moment kjo Deklarate/Certifikate nuk perben shkas per diskriminim, pasi vepron ne harmoni te plote me kushtet rregullatore te parashikuara nga Unioni Europian. Standartet nderkombetare jane standarte qe vendosen per te gjithe proceduren e prokurimit dhe i drejtohen pa perjashtim te gjithe Operatoreve Ekonomike pjesemarres ne procedure duke rnundesuar keshtu ruajtjen e nje profil asnjanes nga Autoriteti Kontraktor. Mjeti i kerkuar objekt prokurimi (rasti konkret peshoret elektronike), duhet te jete i prodhuar ne rnenyre qe ti sherbeje Autoritetit Kontraktor dhe si rrjedhim Deklarata e Konformitetit eshte dokument qe duhet te leshohet nga vete prodhuesi, i cili gezon te drejten te bej transformime apo modifikime te mallit. Se fundmi, Certifikata "CE" duhet me doemos te jete e akredituar nga nje Organizem Nderkombetar ne menyre te tille qe mjeti i kerkuar objekt prokurimi te jete i homologuar enkas per sherbimin postar.

Per sa me siper kerkesa juaj nuk do te pranohet.

• *Ne lidhje me pretendimin e ngritur mbi piken 2.2.8 te "Kriteret e Vecanta per Kualifikim" ku citohet se:*

2.2.8 "Operatori ekonomik duhet te paraqese test raportet ose certifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike, te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga Organizmat Nderkombetare te njohur nga Republika e Shqiperise dhe duhet te plotesoje rregullat teknike per instrumentat mates qe futen ne Republiken e Shqiperise. Te kete shenjen CE, miratimin e tipit, te kete verifikimin fillestar".

Ju bejme me dije se kriteri i mesiperm eshte modifikuar si me poshte vijon:

2.2.8 "Operatori ekonomik duhet te paraqese test raportet ose certifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike, te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga Organizmat Nderkombetare te njohur nga Republika e Shqiperise. Te kete markimin CE, miratimin e tipit, si dhe te kete verifikimin fillestar"

Kerkesa juaj ne lidhje me vendosjen e lidhezes "Ose" (... te kete shenjen "CE" ose te kete ...) bie ndesh me kerkesat dhe nevojat e Autoritetit Kontraktor. Kjo pasi vendosja e nje kriteri te tille ka si qellimi te siguroje Autoritetin Kontraktor ne lidhje me aftesite teknike te operatoreve ekonomike fitues potenciale, ne drejtim te perrnbushjes me sukses te kontrates dhe detyrimeve ne zbatim te saj, konform standardeve te mire percaktuara ne dokumentat e tenderit. Eshte teper e rendesishrne per Autoritetin Kontraktor qe mallrat objekt prokurimi te jene te certifikuara, te harmonizuara me standartet nderkombetare si dhe te shoqeruara me Deklaraten perkatese te Konformitetit. Per Autoritetin Kontraktor eshte bazike vendosja e markimit "CE" per produktin, si dhe shoqerimi me certifikata te cilesise se prodhuesit, certifikata konformiteti ose ekzaminime te tjera te kryera nga institucione te certifikuara per kete qellim, kjo pasi eshte pikerisht markimi me shenjen "CE", i cili garanton cilesine e mallrave dhe ne rastin konkret te peshoreve elekronike. Si konkluzion kerkesa e parashtruar nga Autoritetit Kontraktor per perfshirjen e shenjes "CE" perben nje nevoje te domosdoshme dhe nuk qendron ne kundershtim me parimin e diskriminimit dhe transparences.

Per sa me siper kerkesa juaj nuk do te pranohet.

• *Ne lidhje me pretendimin e ngritur mbi piken 2.2.10 te "Kriteret e Vecanta per Kualifikim" ku citohet se:*

2.2.10. "Ne oren e percaktuar ne njoftimin e kontrates per hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin dorazi, perpara Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO), monstra (kampione), te 1 (nje) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (nje) peshoreje elektronike 50 kg, te cilat duhet te jene sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara. Mos paraqitja e monstrave ne afatin e percaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike eshte kusht per skualifikim".

Nderkaq, Operatori Ekonomik pretendon se nxjerrja e certifikates se kalibrimit kushton dhe duhet te zevendesohet me sherbimin e verifikimit i cili eshte me pak i kushtueshem ne krahasim me procesin e verifikimit. Autoriteti Kontraktor ju sqaron se vendosja e certifikates se kalibrimit perben nje kusht themelor i cili siguron te gjitha te dhenat sasiore te kerkuara nga vete Autoriteti. Certifikata e kalibrimit krijon besueshmerine ne lidhje me perdorimin e mallit duke siguruar rezultate te sakta dhe te besueshme. Si rrjedhim, kushtueshmeria e certifikates nuk mund te merret parasysh nga "Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses" pasi eshte nje pretendim teresisht subjektiv dhe qendron i ngritur mbi nteresa personale. Se fundmi Autoriteti Kontraktor ne kriteret e vendosura ka lene mundesine e perzgjedhjes midis paraqitjes se "test raportit" dhe "certifikates se kalibrimit". Ne kete menyre, Operatori Ekonomik mund te vendose vete se cfare qendron me teper ne interes te tij per te paraqitur.

Pretendimi juaj ne lidhje me vleren e larte monetare te nxjerrjes se Certifikates se Kalibrimit bie ndesh me kriteret e vendosura, pasi ne cdo rast Operatori Ekonomik mund te paraqese "Test Raportin" si alternative te dyte.

Per sa me siper kerkesa juaj nuk do te pranohet.

- *Ne lidhje me pretendimet e ngritura mbi specifikimet teknike:*

Kapaciteti: deri ne 5 kg per Peshoret Elektronike 5 Kg;
Kapaciteti: deri ne 50 kg per Peshoret Elektronike 50 Kg;
Sistemi Operativ: Kompatibel me te gjitha versionet e Windows-it ose ekuivalent nga Windows XP ose ekuivalent deri ne Windows 10 ose ekuivalent;

Sqarojme se ne lidhje me pretendimin tuaj te ngritur mbi "Kapacitetin" ku kerkoni te percaktohet vlera minimale dhe maksimale e kapacitetit, ne menyre qe te nxirret ne pah sasia matese e peshores se ofertuar nga OE, ju bejrne me dije se ne kriteret eshte percaktuar vlera maksimale. Ne lidhje me vleren minimale eshte mjaft e qarte qe ajo nenkuptohet pasi lidheza "deri ne" parashtron si kusht vendimtar vleren maksimale te peshes se objektit, dhe nuk vendos kufizim ne vleren minimale. Specifikimet teknike te hartuara ne perputhje me Nenin 23 te Ligjit per Prokurimet Publike pershkruajne qarte kerkesat e Autoritetit Kontraktor duke ju referuar:

a) Standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkornbetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve apo perdorimin e produkteve;

b) Kerkesave ne terma funksionale, kur nje gje e tille kerkon t'u referohesh standardeve kornbetare ose nderkombetare, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale;

c) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni per mallra, sherbime apo pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Cdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti" i tij/saj.

Nderkaq ne nenin 43 te Ligjit per Prokurimet Publike parashikohet se:

"Autoriteti kontraktor, ne hartimin e dokumenteve te tenderit, perdor dokumentet standarde, sipas percaktimit ne rregullat e prokurimit dhe i ve ne dispozicion falas ne rruge elektronike".

Ne vijim te logjikes se mesiperme vlerat e percaktuara nga Autoriteti Kontraktor jane percaktuar sake dhe qarte. Si konkluzion, Autoriteti Kontraktor ne hartimin e Specifikimeve

Teknike ka permbushur te gjitha kerkesat ne perputhje me paragrafin 3, pikat a, b, c, te nenit 23 te LPP-se.

Per sa me siper kerkesa juaj ne lidhje me kapacitetin nuk do te pranohet.

Ne lidhje me Sistemin Operativ kerkesa juaj per te hequr versionin "Windows XP", gjykohet si e drejte nga Komisioni i Shqyrtimitm te Ankesave.

Per sa me siper kerkesa juaj do te pranohet.

Per permbushjen me sukses te kontrates, Autoriteti Kontraktor, arsyeton se te gjitha Specifikimet Teknike qendrojne te ngritura mbi ide mjaft te qarta dhe nuk bien kurresesi ndesh me legjislacionin ne fuqi.

II.2.2. Në datën 11.12.2019, pala ankimuese operatori ekonomik "*Luar Bros*" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me argumentat si më poshtë vijon:

III. Argumenta dhe analiza ligjore

Ne lidhje me kriterin 2.2.4

Operatori Ekonomik duhet te paraqese per te gjithe artikujt e kerkuar Deklaratat e Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente me te kur jane te aplikueshme sipas direktivave te Keshillit Evropian.

Kjo kerkese bie ndesh me nenin 20 te LPP-se kjo kerkese eshte diskriminuese per arsye se legjislacioni horizontal dhe ai sectorial kane parashikuar rregullat per prodhimin dhe tregtimin e instrumenteve mates. Bazuar edhe ne KPK te DST, nuk ka asnje kufizim ne lidhje me origjinen e produkteve. Kjo kerkese e harmonizuar me kerkesat e meposhtme e ben kushtin qe mallrat te jene prodhuar brenda nje indikacioni te caktuar gjeografik (shih legjislacionin per pronesine industriale), pra nje kufizim edhe per vete produktet shqiptare duke diskriminuar produktet ne baze te origjines. Kujtojme se certifikatat CE jane per indikacionin e tregut te unionit evropian (evropa perendimore) dhe kufizimi bie ndesh me vete kushtet rregullatore te percaktuara ne legjislacionin shqiptar qe lejon tregtimin e instrumenteve te prodhuar edhe ne vende te tjera si ne ballkanin perendimor, azi, amerike, etj.

Ky kusht teknik bie ndesh edhe me nenin 23 te LPP-se qe per nga rendesia e kerkesave teknike, pikesepari i referohet fillimisht standarteve kombetare e ne mungese te tyre jane standartet nderkombetare dhe ne asnje moment nuk ka reference per standarte me indikacione gjeografike te caktuara, qe perbejne bazen e njohjes se origjines se nje produkti, pasi jemi ne kushtet e kufizimit te tregut, konkurrueshmerise dhe diskriminimin mbi baza etnie te ofertuesve/ prodhuesve te tjere. Per me teper ne raport me kerkesat e meposhtme kjo kerkese eshte kufizim hinke, pasi filtron ne kolone kryesore gjithe kerkesat e percaktuara meposhte. Per me teper, rregullatori lejon edhe produktet me markimin CE, si dhe verifikimin e tyre. Persa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri si dispropocional, dhe diskriminues.

Arsyetimi i AK:

Sqarojme se certifikatat CE dhe deklarata e konformitetit sipas direktivave te Keshillit Evropian jane dokumente standarte qe kerkohen ne te gjitha procedurat e prokurimit qe kane si objekt mall, apo sherbim, pasi kjo kerkese vjen ne perputhje me VKM nr. 914, date 29.12.2014 konkretisht neni 30 nenvizohet se:

AK u kerkon ofertuesve certifikata te leshuara nga organ vleresimi konformiteti, i akredituar nga organizma nderkombetar akreditimi, te njohura ne RSH...

Deklarata e konformitetit ne nje kuader te pergjithshem perben nje dokument qe leshohet nga prodhuesi, i cili gezon te drejten te bej transformimin apo modifikimin duke shtuar aksesore specifik per mjetet qe prodhohen nga nje OE i autorizuar/certifikuar nga vete prodhuesi. Ne asnje moment kjo deklarate/certifikate nuk perben shkas per diskriminim, pasi vepron ne harmoni te plote me kushtet rregullatore te parashikuara nga BE. Standartet nderkombetare jane standarte qe vendosen per te gjithe procedurat e prokurimit dhe i drejtohen pa perjashtim te gjithe OE pjesmarres duke mundesuar keshtu ruajtjen e nje profil asnjanes nga AK

Mjeti i kerkuar i prokurimit duhet te jete i prodhuar ne menyre qe ti sherbeje AK dhe si rrjedhim deklarat e konformitetit eshte dokument qe duhet te leshohet nga vete prodhuesi, i cili gezon te drejten te beje transformime apo modifikime te mallit. Se fundmi certifikata CE duhet medoemos te jete e akredituar nga nje organizem nderkombetar ne menyre te tille qe mjeti i kerkuar te jete homologuar enkas per sherbimin postar.

Kunder argument ne KPP:

AK ne pergjigjen e tij deshmoi se po favorizon nje OE duke diskriminuar te tjeret, ne kundershtim me parimet e nenit 2 e 20 te LPP-se. AK i ngatrerron qellimisht nocionet norma teknike dhe standarte teknike. Standartet te cilat i referohet neni 23 i LPP-se nuk kane te bejne me normat teknike. Markimi CE referuar shpjegimeve nuk gjen zbatim ne normativen per standartet ne BE (baza ligjore per standartet ne BE: Regulation (EU) No 1025/2012 of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012 on European standardisation, amending Council Directives 89/686/EEC and 93/15/EEC and Directives 94/9/EC, 94/25/EC, 95/16/EC, 97/23/EC, 98/34/EC, 2004/22/EC, 2007/23/EC, 2009/23/EC and 2009/105/EC of the European Parliament and of the Council and repealing Council Decision 87/95/EEC and Decision No 1673/2006/EC of the European Parliament and of the Council Text eith EEA relevance.

Markimi CE eshte nje tregues qe produkti eshte vleresuar nga prodhuesi dhe gjykohet se ploteson kerkesat e sigurise, shendetesore dhe ambientale te BE-se. Kerkohet per produkte te prodhuara kudo ne bote qe tregtohen ne BE, pra kane si destinacion tregun e BE-se dhe jo tregun ku ndodhet AK (shqiperia ne kete rast pasi ne kete rast rregullimi gjen zbatim nepermjet instrumentave te tjere ligjjore).

(Many products require CE marking before they can be sold in the EU. CE marking indicates that a product has been assessed by the manufacturer and deemed to meet EU safety, health and environmental protection requirements. It is required for products manufactured anyehere in the eorld that are then marketedin the EU".

Si baze ligjore per Markimin CE eshte Rregullorja (EC) No 765/2008, e cila sakteson se eshte nje deklarate prodhuesi qe mban pergjegjesine per te dhenat jane ne perputhje me kerkesat e zbatueshme te BE-se.

"CE marking" shall mean a marking by ëhich the manufacturer indicates that the product is in conformity eith the applicable requirements set out in Community harmonisation legislation providing for its affixing";

Qellimi i kesaj rregullore vendosja e mjeteve te kontrollit per produktet qe vijne nga vendet e treta, si dhe vendosja e nje kuadri per mbikqyrjen e produkteve per te siguruar se ato plotesojne nje nivel te caktuar te mbrojtjes se interest publik, te tille si shendeti, siguria ne pune dhe mbrojtja e ambientit, shih neni 1 pika 2 dhe 3, 4.

2. This Regulation provides a frameeork for the market surveillance of products to ensure that those products fulfil requirements providing a high level of protection of public interests, such as health and safety in general, health and safety at the eorkplace, the protection of consumers, protection of the environment and security.

3. This Regulation provides a frameeork for controls on products from third countries.

4. This Regulation lays doen the general principles of the CE marking.

Pra ne asnje moment ne kete rregullore nuk gjen pohim pretendimi i AK se: Deklarata e konformitetit ne nje kuader te pergjithshem perben nje dokument qe leshohet nga prodhuesi i cili gezon te drejten te bej transformimin apo modifikimin duke shtuar aksesore specifik per mjetet qe prodhohen nga nje OE i autorizuar/certifikuar nga vete prodhuesi.

Kushti qe nje AK qe operon ne Shqiperi kerkon mallra qe vendosen ne BE, duke perjashtuar ato te vendeve te tjera (qe nuk kane si destinacion tregun e BE-se, por edhe tregje te tjera rajonale apo edhe ate shqiptar (pasi jane prodhues rajonal) perben diskriminim pasi kufizon pjesmarrjen e prodhuesve te tjere qe nuk tregtojn ne ne BE duke kufizuar ne kete menyre qarkullimin e lire te mallrave pa nje reference apo kerkese normative ne legjislacionin shqiptar. Referimi ne rregulloret e BE-se eshte disproporcional dhe referuar legjislacionit shqiptar, per metrologjine, produktet jane te lira te tregtohen nga cilido prodhues mjafton te marre vertetim prane institucionit perkates. Nga ana tjeter markimi CE nuk kerkon akreditim, pasi nuk eshte standard. Akreditimi eshte vullnetar per standartet dhe jo per normativat teknike, dhe referimi i gabuar i AK deshmon se po ben qellimisht lemsh per te shitur normativen si standard. Eshte si te thuash te kerkosh qe vetdekalrimin e prodhuesit ta

certifikoje nje ent akreditues (pa pasur kerkese te tille normative/teknike). Pra kemi te bejme me koncepte te ndryshme.

AK pretendon se standartet nderkombetare vendosen per te gjitha procedurat, nderkohe markimi CE nuk ka asnje standard eshte nje vetdeklarate qe per me teper aplikohet jo me standartin Teknik por per plotesimin e kerkesave te sigurise dhe shendetit, te cilat AK nuk i ka ne fenep fare ne kete procedure. Madje injoranca e verber e AK shkon deri aty sa mburret duke deklaruar se deklarata e konformitetit jane dokumenta standarte qe kerkohen ne te gjitha procedurat e prokurimit...

AK cuditerisht nuk ka asnje kunder argument apo justifikim te referuar ne norma, standarte e ligje. Per me teper AK si qershia mbi torte pretendon se prodhuesi gezon te drejten te beje transformime apo modifikime te mallit. Lind arsyeshem pyetja: cfare transformimi nevojitet dhe ne cilen faze? Cfare modifikimi nevojitet dhe kur? Perse AK nuk ka asnje reference te tille ne DT, pasi kjo kerkese bie te jete e pasqaruar ne DT dhe ne kundershtim te hapur me nenin 23 te LPP-se. Dhe per me teper sipas sqarimit qe beme per deklaraten e konformitetit, nuk deshmohet/tregohet kund se kjo deklarate lidhet me ndryshimet e mevonshme apo transformimet e produktit. Por dreqi ta haje cfare modifikimi do i behet nje peshoreje qe del ne treg? Argument per te mospasur argument. Qarte dhe thjeshte nje produkt qe markohet CE nga prodhuesi dhe del ne treg nuk i nenshtrohet modifikimit, pasi eshte audit i ushtruar ne prodhim dhe jo vetem qe nuk lejohet te behet ndryshim (modifikim) bazuar ne legjislaiconin aktual, dhe jo me transformim (pasi transforimi i vetem qe i mbetet AK eshte nxjerrja e tij jashte perdorimit/asgjesimi i tij).

Ajo qe duam te themi eshte se kriteri eshte diskriminues bazuar ne nenin 20 te LPP-se, por edhe ne reference me nenin 23 (qe trajton specifkimet teknike sipas standarteve, rradha e standarteve eshte e qarte, pra hapi i pare iu referohemi standarteve shqiptare e ne mungese te tyre atyre nderkombetare, por ne asnje rast nese standarti ekzston ne vendin ku propozhet kontrata te anashkalohet). Pra kur kerkesa ligjore per standartet ka vendosur kete hierarki veprimesh, nderkohe qe edhe legjislacioni shqiptar nepermjet normativave teknike ka standarte shqiptare dhe lejon standarte apo operimin agjenteve ekonomik nepermjet nje normative teknike te mire percaktuar ne legjislacionin sektorial lejon operimin e tyre ne tregun shqiptar nepermjet marrjes se nje konfirmimi nga organet administrative perkatese, perse ky ngut i AK te misheloje te dyja ne menyre te nderthurur dhe jo harmonizim organik (o njera ose tjetra sikunder e lejon legjislacioni).

Per sa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri sipas pretendimeve tona.

2. Ne lidhje me kriterin 2.2.8

"Operatori Ekonomik duhet te paraqese test raportet ose certifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike, te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga organizmat nderkombetare te njohur nga Republika e Shqiperise dhe duhet te plotesoj rregullat teknike

per instrumentet mates qe futen ne Republiken e Shqiperise. Te kete shenjen CE, miratimin e tipit si dhe te kete verifikimin fillestar".
Argument ne AK

Edhe kjo kerkese referuar dispozitave ligjore te sipercituara bie ndesh pasi legjislacioni lejon dorezimin e ketyre dokumentave ne menyre jo shteruese. Pra, nje produkt me markimin CE nuk i nenshtrohet procedures se verifikimit fillestar, nderkohe qe nje produkt pa kete markim i nenshtrohet.

Ne lidhje me kalibrimin, kalibrimi behet ne laborator (shih nenin 15 te ligjit) dhe vendoset ne operim (pra nuk magazinohet) per arsye se cdo levizje do te bente qe te rikalibrohej. Neni 15 i ligjit percakton qarte dhe sakte se "Kalibrimi i etaloneve te matjeve dhe instrumenteve matese kryhet ne laboratoret e kalibrimit, me kerkesen e perdoruesit". Pra nuk eshte furnitori ai qe e ben kalibrimin por perdoruesi (ne kete rast kalibrimi behet nga ana e Posta Shqiptare ne zbatim te kontrates). Duke qene se legjislacioni lejon qe verifikimi fillestar behet per produkte qe nuk kane markimin CE, atehere nuk ka arsye te kerkohet si dokument plotesues. Pra, kerkojme vendosjen e lidhezes "ose" dhe riformulimin e kriterit: "Te kete shenjen/markimin CE ose te kete miratimin e tipit, verifikimin fillestar"

Arsyetimi i AK-se.

Kerkesa jone per vendosjen e lidhezes "ose" bie ndesh me kerkesat e AK se vendosja e nje kriteri te tille ka si qellim te siguroje AK ne lidhje me aftesite teknike te OE fitues potenciale, ne drejtim te permbushjes me sukses te kontrates dhe detyrimeve ne zbatim te saj, konform standarteve te mire caktuara.

Kunder argument ne KPP:

AK gjykon se eshte bazike vendosja e markimit CE, nderkohe qe ne ligjin per metrologjine lejohen te gjithe mundesite e tregtimit. Pra ka vend per produkte te markuara CE, made is usa, apo made in Albania. Fakti qe AK kembengul per nje prodhues qe tregton ne nje indikacion gjeografik te caktuar jashte te cilit eshte edhe vete si treg, e ben situaten jo vetem te paligjshme dhe disproporcionale por edhe penalizuese per prodhues qe nuk duan te tregtojne ne BE, por ne vende te tjera perfshire edhe tregun shqiptar qe e lejon kete mundesi.

Persa me siper i gjejme pretendimet e AK te paligjshme dhe te pabazuar ne dispozita ligjore ne fuqi ne RSH dhe teresisht disproporcionale.

Kerkojme vendosjen e lidhezes "ose" dhe riformulimin e kriterit: "Te kete shenjen/markimin CE ose te kete miratimin e tipit, verifikimin fillestar" sikunder parashikohet ne nenin 18/2 te ligjit 10489 "Per Tregtimin dhe Mbikeqyrjen e Tregut te Produkteve jo Ushqimore / 2011".

3. Ne lidhje me kriterin 2.2.10

"Ne oren e percaktuar ne njoftimin e kontrates per hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin dorazi perpara Komisionit te Vleresimit te Ofertave (KVO), mostra (kampione), te 1 (nje) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (nje) peshoreje elektronike 50 kg te cilat duhet te jene sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara. Mos paraqitja e mostrave ne afatin e percaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike eshte kusht per skualifikim".

Ndersa ne specifkimet teknike jane kerkuar nder te tjera: Kontraktuesi te paraqese Certifikate kalibrimi ose Test Raport:

Argumentne AK:

Kjo kerkese eshte tejet disproporcionale pasi i bie qe OE te dorezoje certifikatat e kalibrimit ose test raportet per cdo produkt (pra per mbi 100 artikuj). Per me teper certifikata e kalibrimit bazuar ne nenin 15 dhe 63 te ligjit per Metroliogjine "Kalibrimi i etaloneve te matjeve dhe instrumenteve matese kryhet ne laboratoret e kalibrimit, me kerkesen e perdoruesit" kane nje pagese te konsiderueshme, dhe bazuar ne udhezimet e ministrise pergjegjese, certifikata e kalibrimit leshohet ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me kerkese te pales blerese.

Pra nga menyra e vendosjes se kerkeses nuk mjafton dokumentacioni per mostren, por per te gjithe artikujt, duke qene se referenca e kriterit eshte bere tek specifkimet teknike pa e dalluar ate si kriter i posacem per mostren e kerkuar. Madje nuk kerkohet as akti i verifkimit qe eshte kerkesa kryesore, pasi kalibrimi behet ne nje faze te mevonshme referuar legjislacionit per metrologjine. Kerkojme heqjen e fjalise: "te cilat duhet te jene sipas te gjitha specifikimeve teknike te kerkuara" dhe te saktesohet specifikimi vetem per mostren e kerkuar ne lidhje me test raportin ose certifikate ne verifikimit.

Arsyetimi i AK:

"Certifikata e kalibrimit krijon besueshmerine ne lidhje me perdorimin e mallit duke siguruar rezultate te sakta dhe te besueshme. Kushtueshmeria e certifikates eshte nje pretendim teresisht subjektiv dhe qendron i ngritur mbi interesa personale". Por nga ana tjeter AK refuzon kerkesen tone por ben nje sqarim te pasaktesuar ne shtojce te vecante, kur sqaron se: pretendimi juaj ne lidhje me vleren e larte monetare te nxjerrjes se certifikates se kalibrimit bie ndesh me kriteret e vendosura, pasi ne cdo rast OE mund te paraqese test raportin si alternative te dyte.

Kunder argument e KPP:

Pra ne kete rast AK nuk ka trajtuar kerkesen tone ne teresi pasi nuk ka trajtuar kerkesen tone per te sqaruar nese duhet dokumetacioni per mostren apo per te gjithe artikujt. Duke mos e dalluar ate si kriter te psoacem AK qellimisht ka devijuar thelbin e kerkeses qe kishte te bente me nje saktesim te kerkeses per mostren dhe jo duke e lene ate te hapur, sic rezulton nga vete pergjigja e AK. Pra standarti i AK eshte vete vulos vete vleresoj, vete arsyetoj e interpretoj.

AK edhe e len te hapur mundesine e altemativave, por nga ana tjeter nuk shpjegon fare as ne ankese e jo me sqarim per gjithe OE te interesuar saktesimin nese dokumentacioni duhet per mostrat apo per gjithe artikujt, duke iu devijuar kerkeses specifike dhe ankeses sone se formulimi le hapesira per interpretim te gjere diskrecional por te paligjshem ne momentin e vleresimit te ofertave. Kerkojme nga KPP te detyroje AK te jape pergjigje ne lidhje me kete mungese dhe te detyroje AK te beje qartesimin e dokumentacionit te kerkuar per mostrat vetem dhe jo per te gjithe artikujt pasi eshte nje kerkese disproporcionale.

4. Ne lidhje me specifkimet teknike,

Argumente ne AK:

Verejme se ne emertimin e produktit peshore 5 kg dhe peshore 50 kg, ka percaktuar si kapacitet maksimal deri ne 5 kg dhe deri ne 50 kg. Ky kriter nuk ka marre fare parasysh kerkesat per percaktimin e vleres minimale dhe asaj maksimale, sipas VKM Nr. 631/ 25.09.2019 "Per miratimin e rregullit Teknik per instrumentet e peshimit jo automatik dhe percaktimin e listes se standarteve te harmonizuara". Sipas kesaj llogjike te vendosur nga AK i bie te refuzohet nje peshore qe mat 6-kg dhe te pranohet nje peshore qe mat 1-kg, pavarsisht emertimit te peshores. Specifikimet teknike referuar nenit 23 duhet te garantojne trajtim te barabarte te OE. Nga menyra e vendosjes se kesaj kerkese, pa nxjerre ne pah qarte peshen maksimale qe duhet te mase peshorja per secilin model te kerkuar, ne kundershtim me VKM nr. 631/ 25.09.2019, e ben kete kerkese keqorientuese per OE, ne rastin me te mire, dhe favorizuese (per OE e preferuar) nga AK ne zbatim te kontrates duke cenuar rregullat e gares se ndershme ndermjet OE.

Kontraktuesi te paraqese Certiflkate kalibrimi ose Test Raport:

Ne lidhie me kete kriter sic e parashtruar me siper duke qene se certifikata e kalibrimit behet ne vendin e ushtrimit te aktiviteit nga bleresi kerkojme te hiqet dhe te lejohet certiflkata e verifikimit pa permendur faktin se certiflkata e kalibrimit behet ne vend perdorim nga perdoruesi dhe jo nga furnitori dhe perben nje kosto te shtuart te padrejte referuar nenit 63 te LPM dhe kufizon konkurrencen.

Kerkesa e AK se Kontraktuesi duhet te paraqese certifikatat e kalibrimit, referuar nenit 15 te Ligjit per Metrologjine: "Kalibrimi i etaloneve te matjeve dhe instrumenteve matese kryhet ne laboratoret e kalibrimit, me kerjesen e perdoruesit". Ne kete menyre kerkesa behet ne zbatim te kontrates dhe ne reference te kesaj kerkese ligjore duke qene se kalibrimi do te behet ne vend instalim me koston e furnitorit, ne baze te kerkeses se perdoruesit pra ne kete rast Posta Shqiptare sh.a (furnitori bazuar ne legjislacionin sectorial nuk eshte perdorues por furnitor/shperndares) vihet re magnesia thelbesore e vendodhjes se instalacioneve te peshoreve pasi kjo perben kosto per OE ofertues. Duke qene se kalibrimi do te behet ne vend, dhe bazuar ne standartet e metrologjise, furnitori do e dergoj ate ne vendinstalim dhe ne baze te kerkeses se Posta Shqiptare sh.a do te behet kalibrimi nga strukturat e akredituara shteterore. Por per te plotesuar kushtet e nenit 23, AK eshte i detyruar te jape listen shteruese

te vendodhjes se instalimit te peshoreve ne menyre qe OE te hartojne oferten dhe te marrin persiper rrezikun e kostove te transportit, ekipit kalibrues dhe tarifes se kalibrimit. Pra ne referim te bazes se mesiperme ligjore kerkojme heqjen e kerkeses per paraqitjen e certifikates se kalibrimit per arsye se behet ne perfundim te kontrates me kerkese te perdoruesit. Bazuar ne kerkesat e ligjit per metrologjine kjo kerkese nuk eshte e detyrueshme per produktet e markuara CE, pasi eshte nje aktivitet vullnetar, nderkohe qe ligji per metrologjine kapercaktuar certifikaten e verifikimit si kusht Teknik per verifkimin e instrumenteve mates. te percaktohet si kusht per realizimin e kontrates ose vendosjen e kerkeses per ne referim te dispozitave ligjore te sipercituara, Kodit Civil, Kodit te Procedurave Administrative ne lidhje me specifkimet teknike kerkojme:

Kapaciteti: deri ne 5 kg dhe 50 kg te percaktohet vlera minimale dhe ajo maksimale e kapacitetit ne menyre qe te nxjerre ne pah sasine matese te peshores se ofertuar nga OE.

Sistemi Operativ: Kompatibel me te gjitha versionet e Ëindoës-it nga Ëindoës XP deri ne Ëindoës 10 kerkojme qe ky kriter te hiqet per versionin ëindoës XP, duke qene se suporti per kete version ka mbaruar prej vitesh dhe nuk eshte me ne perdorim vec nese AK kerkon te marre produkte te vjetra dhe jo te reja.

Per me teper test raporti nuk njihet ne verifikim apo konformitet, dhe del nje dokument jo proporcional me rendesine e te dytave.

Ne perfundim kerkojme qe ne cdo kerkese te AK ku i referohet certifikates se kalibrimit te hiqet si kerkese per arsye se kalibrimi eshte vullnetar dhe i pakerkuar per disa tipe produktesh sipas legjislaiconit sektorial per metrologjine (pra ato te markuara CE). Ne vend te kesaj kerkese te kerkohet certifikata e verifikimit fillestar qe eshte detyrim ligjor per cdo produkt. Per me teper certifikata e kalibrimit behet nga perdoruesi ne zbatim dhe nese do te vendoset si kusht zbatimi ne kontrate, atehere AK te detyrohet te jape listen e vend dislokimit te peshoreve.

Kerkojme heqjen e test raportit per arsye se nuk eshte nje dokument qe njihet nga organet shteterore referuar legjislacionit per metrologjine, ndonese eshte nje dokument i prodhuesit. Kerkojme saktesimin e specifikimeve teknike per vleren minamele dhe maksimale te peshimit dhe jo vendosjen e kapacitetit deri ne 5/50 kg pasi krijon kushte per konkurim te padrejte dhe privilegje te fshehura.

Shqyrtimi administrative dhe rezultatet e AK: refuzim i kerkeses se ankimuesit.

Kunder argument e KPP:

E vetmja gje e kuptuar prej tyre eshte se Windows XP nuk ka me ne qarkullim (shyqyr qe ja kujtuam).

Madje edhe per referencen ligjore per peshoret nuk e kane vene ujin ne zjarr per ta lexuar per permiresimin e njohurive te tyre juridike e teknike.

AK ka vendosur nenin 23 dhe i mjafton shprehja se vlera minimale eshte mjaft e qarte pasi lidheza "deri ne" parashtron si kusht vendimtar vleren maksimale te peshes se objektit..... O tempora o mores. Shpresojme qe AK ne shqyrtimin e ankeses ta kete bere me dt. 26.11.2019, nen efektet traumatike te jetes se perditshme, pasi lidheza "deri ne" trajtohet si kufi maksimal nderkohe qe ne cdo AK e ne cdo procedure kjo lidhez deshmon se eshte kerkese e shkallezuar dhe pa tavan maksimal te kerkuar.

Kerkojme nga KPP te detyroje AK te beje korrigjimin e termit dhe lidhezes "deri ne" sepse nga menyra e kerkuar nuk del kuptimi i qarte ne lidhje me kete kerkese duke e bere ate bjere ndesh me kerkesat e nenit 23 te LPP-se.

Permbledhje:

Ne cdo rast, nje instrumenti mates ligjerisht i kontrolluar apo jo mund ti kryhet kalibrim apo verifikim. Ne perfundim te secilit proces per te demonstruar konformitetin e instrumentit, leshohet certifikate kalibrimi apo certificate verifikimi. Ne asnje rast nuk ka mbeshtetje ne akte ligjore apo direktiva pasi nuk permendet "test raporti" si dokument ekuivalent me certifikatat e kalibrimit apo verifikimit.

Kur nje instrument mates eshte objekt i markimit CE konsiderohet se miratimi i tipit dhe verifikimit fillestar eshte kryer nga prodhuesi me vetdeklarim apo nga nje trupe notifikuese. Kjo behet ne baze te dispozitave dhe rregullave te te gjitha direktivave evropiane per kushtet e vendosjes se markimit CE dhe ne mbeshtetje te rregullores NAWI.

Duke qene se AK keto peshore do i perdore per te kryer transaksione tregtare, konsumatori duhet te mbrohet nga matjet e pasakta sipas akteve ligjore te sipercituara, gje e cila do te thote se keto peshore jane pjese e instrumenteve mates ligjerisht te kontrolluara dhe kane detyrimin ligjor te verifikohen periodikisht cdo nje vit.

Mjafton qe AK te njoftoje institucionet perkatese si Inspektoriatin Shteteror te Mbikqyrjes se Tregut ISHMT dhe DPM per llojin e peshores objekt markimit CE, vendin dhe daten e vendosjes ne perdorim.

Persa me lart OE nuk duhet te kete asnje detyrim tjeter pervec se instrumenti te jete objekt i markimit CE, ose verifikimit fillestar (pra o njeres o tjetres) dhe jo te dyjave bashke ne menyre te nderlidhur, riformulimin e kerkeses per dokumentacionin qe duhet te shoqerojne mostrat.

Ne lidhje me kerkesen per paraqitjen e certifikates se kalibrimit, ky i fundit (Kalibrimi) ne kete rast pervec kostos se larte qe ka nje process i tepert (ekstra ligjor) i kryer mbi verifikimin filletsar qe ka kryer prodhuesi duke qene se peshorja do te jete ne pronesi dhe perdorim te

AK-se (gjate zbatimit te kontrates), ky i fundit ka detyrimin ligjor qe cdo vit nga data e vendosjes se instrumentit ne pune te kryeje verifikimin periodik. Pra eshte nje proces ne zbatim te kontrates, dhe kerkesa eshte irrelevante dhe AK ka tejkaluar testin e proporcionalitetit ne diskrecionin e lejuar nga LPP pasi:

a) nuk eshte i nevojshem per te arritur qellimin e kerkuar nga LPP (sepse referuar legjislacionit sektorial behet nga perdoruesi kur produkti eshte ne perodrim) dhe e arrin ate me mjetet dhe masat qe me pak te drejtat apo interest legjitime te pales (te OE ne kete rast) me dorezimin e certifikatave te vleresimit ose te markimit CE;

b) nuk eshte i pershtatshem per te arritur qellimin e parashikuar ne ligj, per arsye vete ligji per metrologjine parashikon klientin/perdoruesin te beje kerkesen per kalibrim dhe jo distributorin/shitesin;

c) nuk eshte ne perpjestim te drejte me nevojen qe e ka diktuar ate, pasi nevoja eshte qe AK duhet te krijoje bindjen se produkti ploteson specifikimet teknike, ndersa zbatimi i kontrates kerkon (shih Kushtet e Pergjithshme te Kontrates ne DT) parashikon testimin dhe inspektimin e produkteve qe do te levrohen dhe do vihen ne operim nga AK. Pra referuar kerksave te DT dhe legjislacionit sectorial ai behet ne zbatim nga vete perfituesi/operuesi.

Konkluzione

Kërkojmë pranimin e pretendimeve tona sipas argumentave të paraqitura për cdo parregullsi të konstatuar nga ana jone në lidhje me këte procedurë prokurimi.

II.3. Me shkresën me nr. 2999/11 prot, datë 24.12.2019, protokolluar me tonën me nr. 1866/2 prot, datë 26.12.2019, me objekt "*Informacion*" është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III
Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Luar Bros"* shpk se: "*Operatori Ekonomik duhet te paraqese per te gjithe artikujt e kerkuar Deklaratat e Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente me te kur jane te aplikueshme sipas direktivave te Keshillit Evropian. Kjo kerkese bie ndesh me nenin 20 te LPP-se kjo kerkese eshte diskriminuese per arsye se legjislacioni horizontal dhe ai sectorial kane parashikuar*

rregullat per prodhimin dhe tregtimin e instrumenteve mates. Bazuar edhe ne KPK te DST, nuk ka asnje kufizim ne lidhje me origjinen e produkteve. Kjo kerkese e harmonizuar me kerkesat e meposhtme e ben kushtin qe mallrat te jene prodhuar brenda nje indikacioni te caktuar gjeografik (shih legjislacionin per pronesine industriale), pra nje kufizim edhe per vete produktet shqiptare duke diskriminuar produktet ne baze te origjines. Kujtojme se certifikatat CE jane per indikacionin e tregut te unionit evropian (evropa perendimore) dhe kufizimi bie ndesh me vete kushtet rregullatore te percaktuara ne legjislacionin shqiptar qe lejon tregtimin e instrumenteve te prodhuar edhe ne vende te tjera si ne ballkanin perendimor, azi, amerike, etj. Ky kusht teknik bie ndesh edhe me nenin 23 te LPP-se qe per nga rendesia e kerkesave teknike, pikesepari i referohet fillimisht standarteve kombetare e ne mungese te tyre jane standartet nderkombetare dhe ne asnje moment nuk ka reference per standarte me indikacione gjeografike te caktuara, qe perbejne bazen e njohjes se origjines se nje produkti, pasi jemi ne kushtet e kufizimit te tregut, konkurrueshmerise dhe diskriminimin mbi baza etnie te ofertuesve/ prodhuesve te tjere. Per me teper ne raport me kerkesat e meposhtme kjo kerkese eshte kufizim hinke, pasi filtron ne kolone kryesore gjithe kerkesat e percaktuara meposhte. Per me teper, rregullatori lejon edhe produktet me markimin CE, si dhe verifikimin e tyre. Persa me siper kerkojme heqjen e ketij kriteri si dispropocional, dhe diskriminues". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 8/2, *"Kriteret e Veçanta të Kualifikimit"*, pika 2.2.4 *"Kapaciteti teknik"*, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.2.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë për të gjithë artikujt e kërkuar Deklaratat e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente me të kur janë të aplikueshme sipas direktivave të Këshillit Evropian;

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar parashikohet se : *" […] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet se: *"[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. […]*".

III.1.4. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se "*1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë*

kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit." 2.Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit".

III.1.5. Në nenin 27 "Kontratat e Mallrave" pka 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar parashikohet se: "*Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:"*

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se paraqitja e deklaratës së konformitetit EC/Certifikatë CE ose ekuivalente me të, është një kërkesë e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe duke qenë se, autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallërat që do të ofertojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata për të vërtetuar konformitetin e prodhimit të produkteve që do të përdoren në procedurën objekt prokurimi, aq më tepër që në kërkesën e bërë autoriteti ka përdorur edhe termin ose ekuivalent të parashikuar në nenin 23 të LPP.

Gjithashtu sqarojmë se vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: *"[…] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike,*

aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]". Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik gjatë ofertimit të tyre të provojnë së zotërojnë kapacitete teknike lidhur me deklaratën e konformitetit EC/Certifikate CE ose ekuivalente me të për artikujt objekt prokurimi. Pretendimi i ankimuesit se një përcaktim i tillë kufizon produktet e prodhuara edhe në vënde të tjera nuk qëndron, pasi autoriteti kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim ndër të tjera ka parashikuar se, për artikujt objekt prokurimi, operatorët ekonomik duhet të paraqesin deklaratën e konformitetit EC/Certifikate CE ose ekuivalente me të. KPP gjykon se, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikimi vëndin e origjinës për artikujt objekt prokurimi, i cili, do të ishte diskriminues dhe i ekzagjëruar për vetë faktin se do të kufizonte pjesmarrjen e operatorëve ekonomik, të cilët kryejnë furnizime të së njëjtës natyre për produkte të certifikuar CE, por që janë prodhuar në vënde te tjera. Referuar në sa më sipër, KPP gjykon se vendosja e kriterit të paraqitjes së deklaratës së konformitetit EC/Certifikate CE ose ekuivalente me të, ka si qëllim të sigurojë autoritetet kontraktore mbi aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë fitues potencialë, në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standardeve të mirëpërcaktuara në dokumentat e tenderit, nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktor është mjaftuar që mallrat objekt prokurimi të jenë të certifikuara konformë standarteve ndërkombëtare si dhe të shoqëruara me deklarata konformiteti. Komisioni gjykon se në rastin konkret rezulton se ky specifikim është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës e si rezultat nuk ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurencës dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi dhe nuk bie në kundërshtim me nenin 1, pika 2 e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Sa më sipër, KPP gjykon se kriteri për paraqitjen e deklaratës së konformitetit EC/Certifikate CE ose ekuivalente me të, në rastin konkret, është proporcional me objektin dhe natyren e kontratës objekt prokurimi.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Luar Bros"* shpk se: "*Operatori Ekonomik duhet te paraqese test raportet ose certifikatat e kalibrimit per peshoret elektronike, te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ose nga organizmat nderkombetare te njohur nga Republika e Shqiperise dhe duhet te plotesoj rregullat teknike per instrumentet mates qe futen ne Republiken e Shqiperise. Te kete shenjen CE, miratimin e tipit si dhe te kete verifikimin fillestar". Edhe kjo kerkese referuar dispozitave ligjore te sipercituara bie ndesh pasi legjislacioni lejon dorezimin e ketyre dokumentave ne menyre jo shteruese. Pra, nje produkt me markimin CE nuk i nenshtrohet procedures se verifikimit fillestar, nderkohe qe nje produkt pa kete markim i nenshtrohet. Ne lidhje me kalibrimin, kalibrimi behet ne laborator (shih nenin 15 te ligjit) dhe vendoset ne operim (pra nuk magazinohet) per arsye se cdo levizje do te bente qe te rikalibrohej. Neni 15 i ligjit percakton qarte dhe sakte se "Kalibrimi i etaloneve te matjeve dhe instrumenteve matese kryhet ne laboratoret e kalibrimit, me kerkesen e perdoruesit". Pra nuk eshte furnitori ai qe e ben*

kalibrimin por perdoruesi (ne kete rast kalibrimi behet nga ana e Posta Shqiptare ne zbatim te kontrates). Duke qene se legjislacioni lejon qe verifikimi fillestar behet per produkte qe nuk kane markimin CE, atehere nuk ka arsye te kerkohet si dokument plotesues. Pra, kerkojme vendosjen e lidhezes "ose" dhe riformulimin e kriterit: "Te kete shenjen/markimin CE ose te kete miratimin e tipit, verifikimin fillestar". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në Shtojcën 8/2, të modifikuar tek "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit"*, pika 2.2.8 *"Kapaciteti teknik"*, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Ishte:

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë test raportet ose certifikatat e kalibrimit për peshoret elektronike, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga organizmat ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe duhet të plotësoj rregullat teknike për instrumentet matës që futen në Republikën e Shqipërisë. Të ketë shenjën CE, miratimin e tipit si dhe të ketë verifikimin fillestar.

Bëhet:

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë test raportet ose certifikatat e kalibrimit për peshoret elektronike, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga organizmat ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Të ketë markimin CE, miratimin e tipit si dhe të ketë verifikimin fillestar.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar parashikohet se : *" […] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.2.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet se: *"[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. […]*".

III.2.4. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se "*1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose*

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit." 2.Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit".

III.2.5. Në nenin 27 "Kontratat e Mallrave" pika 6/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", të ndryshuar parashikohet se: "*Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:"*

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.2.7. Në kriterin e vecantë të kualifikimit në shtojcën 8 "*kapaciteti teknik*" konstatohet se në pikën 2.2.8. kapaciteti teknik është kërkuar përkatësisht "*Operatori Ekonomik duhet të paraqesë <u>test raportet</u> ose <u>certifikatat e kalibrimit</u> për peshoret elektronike, të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga organizmat ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Të ketë markimin CE, miratimin e tipit si dhe të ketë verifikimin fillestar.*" Në lidhje me pretendimin e ankimuesit përsa i përketë *test raporteve ose certifikatave të kalibrimit*, Komisioni konstaton se, është një kërkesë në përputhje me objektin mallit që do të lëvrohet në zbatim të kontratës objekt prokurimi, pasi referuar rëndësis dhe funksionit që do të kryej pajisja matëse (peshore elektronike) është tepër e nevojshme paraqitja e certifikatave të kalibrimit, pasi kalibrimi i pajisjes është e lidhur ngushtësisht me qëllimin e realizimit të objektit të prokurimit. Në këtë kontekst referuar pretendimit të ankimuesit për heqjen e kriterit, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme dhe e ka gjykuar si të domosdoshme kërkesën në lidhje me <u>certifikatat e kalibrimit</u>, të lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe në përpjesëtim me kontratën objekt shqyrtimi. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ndërsa përsa i përket kërkesës se "*Të ketë markimin CE, miratimin e tipit si dhe të ketë verifikimin fillestar.*" KPP gjykon se në kushtet kur procedura e prokurimit është një kontratë malli dhe mallrat do të lëvrohen dhe do të paraqiten në autoritetin kontraktor si një produkt i vetëm (produkt final) i cili eshte i certifikuar në tërësinë e tij dhe përmbush standartet

europiane të konformitetit sipas normativave CE e vërtetuar kjo me paraqitjen e deklaratës së konformitetit, kërkimet e dokumentave të tjera si *miratimin e tipit apo dhe të verifikimit fillestar* lidhur me kriterin e sipërcituar janë të ekzagjëruar, diskriminues, përjashtues dhe jo në përputhje me objektin dhe natyrën e objektit të prokurimit, duke kufizuar konkurencën dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duke rënë në kundërshtim me nenin 1, pika 2 e Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar e, ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e tij.

III.2.8. Gjithashtu lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se dokumentacioni test raport ose certifikatë kalibrimi duhet vetëm për mostrën apo për të gjithë artikujt objekt prokurimi. KPP gjykon se autoriteti kontraktraktor ka detyrimin të sqarojë ofertuesit për cdo kriter apo specifikim teknik në mënyrë të detajuar, pasi përcaktimi i paraqitjes së dokumentacionit të mësipërcituar vetëm për mostrën apo për të gjithë artikujt objekt prokurimi ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e ofertimit të operatorëve ekonomikë pjesmarrës. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë sqarimet përkatëse lidhur me përcaktimin e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërcituar për mostrën apo për të gjith artikujt në tërësi si dhe njëherazi të bëjë edhe publikimin e sqarimit përkatës dhe të modifikimit në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: "*Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit".*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Luar Bros*" shpk për modifikimin e kriterit "*Kërkojmë heqjen e fjalise: " mostrat kampionet duhet të jenë sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara".*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 "*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*" pika 2.3 "*Kapaciteti Teknik*" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

2.2.10 Në orën e përcaktuar në njoftimin e kontratës për hapjen e ofertave, Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin dorazi, përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), ***mostra (kampione)****, të 1 (një) peshoreje elektronike 5 kg dhe 1 (një) peshoreje elektronike 50kg,* ***të cilat duhet të jenë sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara****. Mos paraqitja e mostrave në afatin e përcaktuar dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.*

III.3.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", neni 27 "*Kontratat e mallrave*", pika 6 përcaktohet "*Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si*:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.3.3. Komsioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.3.4. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, KPP gjykon se, qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuar nga autoriteti kontraktor në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Në rastin konkret Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka kërkuar kampione mostra për produktet e prokuruara të cilat nuk janë të ekzagjeruara në numër dhe dorëzimi i tyre është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së specifikimeve teknike me mostrat e dorëzuara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër KPP gjykon se paraqitja e mostrave në përputhje me specifikimet teknike është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara, proporcionale me objektin e prokurimit dhe lehtësisht e mundur për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit në lidhje me kërkesën së *"[...] duhet të jepen të dhëna më të detajuara në specifikimet teknike në lidhje me kapacitetin e peshoreve deri në 5 kg dhe deri në 50 kg; të përcaktohet vlera minimale dhe ajo maksimale e kapacitetit në mënyrë që të nxjerrë në pah sasinë matëse të peshores së ofertuar nga OE [....]"* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 9 "*Specifikimet teknike*", të dokumenteve të tenderit për proçedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Peshore Elektronike 5 Kg

Tipi: *Peshore tavoline dixhitale, të përshtatshme për letra, paketa dhe koliposta dhe të jetë e thjeshtë në funksionim, të ketë të integruara aplikime me dy butona;*
Përmasat e pllakës së peshimit: *250mm – 300mm X 200mm – 250mm;*
Pllaka e peshimit*: Pllaka e peshimit të jetë metalike dhe e lëvizshme për pastrim;*
Kapaciteti: *deri në 5 Kg;*
Gabimi maksimal i lejuar:*+-2gr;*
Njësite matëse: *gram, kilogram;*
Ushqimi: *Të jetë i pajisur me kabllo të ushqimit me tension 220V/50Hz sistem evropian dhe sistem funksionimi me bateri. Funksionim dhe me bateri, të cilat duhet të jenë të karikueshme dhe të mbajnë peshoren në punë ≥12 orë;*
Ndërfaqet e komunikimit: *RS232 Standard ose USB 1.1/2.0. Të jenë të përfshira në paketim kabllot lidhëse përkatës USB 1.1/2.0 ose serial RS232 të cilat transferojnë informacionin e peshës së matur automatikisht në PC nëpërmjet protokollit SERIAL në rastin RS232 ose emulim të portës seriale në rastin e USB1.1/2.0;*
Sistemi Operativ*: Kompatibël me të gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri në Windows 10;*
Kalibrimi: *Kalibrim të paktën në një pike dhe funksion auto-zerimi;*
Ekrani: *Të shfaqi peshën në kohë reale dhe ekrani të jetë i tipit LCD/LED. Numrat ne ekran jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distanca;*
Stabiliteti i leximit të peshimit*: Jo më shumë se 3 sek;*
Garancia: *Kontraktuesi duhet të ofrojë garanci për 1 vit;*
Kontraktuesi te paraqesë Certifikate kalibrimi ose Test Raport;
Manuali përdorimit: *Përfshirë në paketim.*

Peshore Elektronike 50Kg

Tipi: *Peshore dixhitale, të përshtatshme për thasë, koliposta mbi 5kg apo objekte të tjera;*
Karakteristika e peshores: *Peshorja duhet të jetë e lëvizshme;*
Përmasat e pllakës së peshimit*: 300mm – 400mm X 300mm – 400mm;*
Përmasat e indikatorit*: 200mm – 220 mm X 100mm – 150mm X 50 – 80mm;*
Materiali i pllakës së peshimit*: Metalike;*
Kapaciteti*: deri ne 50 Kg;*
Gabimi maksimal i lejuar*:+-20g;*
Lineariteti*: +-40g;*
Njësite matëse*: gram, kilogram;*

Ushqimi: *Të jetë i pajisur me kabllo të ushqimit me tension 220V/50Hz sistem evropian dhe sistem funksionimi me bateri. Funksionim dhe me bateri, të cilat duhet të jenë të karikueshme dhe të mbajnë peshoren në punë ≥ 60 orë;*
Ndërfaqet e komunikimit*: RS232 Standard ose USB 1.1/2.0. Të jenë të përfshira ne paketim kabllot lidhëse përkatës USB 1.1/2.0 ose Serial RS232 të cilat transferojnë informacionin e peshës se matur automatikisht në PC nëpërmjet protokollit SERIAL ne rastin RS232 ose emulim te portës seriale në rastin e USB 1.1/2.0;*
Sistemi Operativ*: Kompatibël me të gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri në Windows 10;*
Kalibrimi*: Kalibrim të paktën në një pike dhe funksion auto-zerimi;*
Ekrani*: Të shfaqi peshën në kohë reale dhe ekrani të jetë i tipit LCD/LED. Numrat ne ekran jenë jo më pak se 25mm, në funksion të leximit nga distanca;*
Garanci*a: Kontraktuesi duhet të ofrojë garanci për 1 vit;*
Kontraktuesi te paraqesë Certifikate kalibrimi ose Test Raport;
Manuali përdorimit*: Përfshirë në paketim*

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar kthim përgjigjes Nr. 2999/8 prot datë 03.12.2019 të autoritetit konteraktor konkretisht citohet:

[…] Në lidhje me pretendimet e ngritura mbi specifikimet teknike: Kapaciteti: deri në 5 kg për Peshoret Elektronike 5 Kg; Kapaciteti: deri në 50 kg për Peshoret Elektronike 50 Kg;

Sqarojme se në lidhje me pretendimin tuaj të ngritur mbi "Kapacitetin" ku kërkoni të përcaktohet vlera minimale dhe maksimale e kapacitetit, në mënyrë që të nxirret në pah sasia matëse e peshores së ofertuar nga OE, ju bëjmë me dije se në kriteret është përcaktuar vlera maksimale. Në lidhje me vlerën minimale është mjaft e qartë që ajo nënkuptohet pasi lidhëza "deri në" parashtron si kusht vendimtar vlerën maksimale të peshës së objektit, dhe nuk vendos kufizim në vlerën minimale. Specifikimet teknike të hartuara në përputhje me Nenin 23 të Ligjit për Prokurimet Publike përshkruajnë qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor duke ju referuar:

a) Standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standarteve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standartizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standarteve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) Kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standarteve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Cdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti" i tij/saj.

Ndërkaq në nenin 43 të Ligjit për Prokurimet Publike parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarte, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike".

Në vijim të logjikës së mësipërme vlerat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor janë përcaktuar saktë dhe qartë. Si konkluzion, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike ka përmbushur të gjitha kërkesat në përputhje me paragrafin 3, pikat a, b, c, të nenit 23 te LPP-së. […].

III.4.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publike (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brënda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të Ligjit për Prokurimin Publik. K.P.P sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit/shërbimit/punës dhe angazhimet e ofruara do të jenë të njëjtë me cilësinë dhe angazhimet e premtuar në ofertë. KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik i dispozitave të sipërcituara arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurim të drejtë, të hapur dhe gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si dhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Sa më sipër, K.P.P gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike duhet të mbajë në vemendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 56 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27, pika 1 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*", i ndryshuar. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë / përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe / ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se këto kërkesa nuk duhet të jenë kufizuese dhe përcaktuese drejt një prodhuesi të caktuar, por duhet të lejojnë kapacitet mbi një minimum të caktuar pra të jepen të dhëna në vlera minimale dhe maksimale duke iu shmangur parametrave përcaktues të detajuar të cilët kufizojnë pjesëmarrjen e shoqërive, por duke e lënë opsionale plotësimin e kërkesës së mësipërme, duke parashikuar një minimum dhe maksimum përsa i përketë peshës që do të masë pështorja elektronike, duke e zgjeruar në

këtë mënyrë konkurrencën dhe duke lejuar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron, ndaj autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet përkatëse duke parashikuar një minimum dhe një maksimum në lidhje me pëshën që do të masë peshorja elektronike.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "*Luar Bros*" sh.p.k se: "*Në DST Specifikimet Teknike kërkohet Sistemi Operativ Kompatibel me te gjitha versionet e Windows-it nga Windows XP deri ne Windows 10 kërkojmë që ky kriter të hiqet për versionin Windows XP, duke qënë se suporti për këtë version ka mbaruar prej vitesh dhe nuk është më në përdorim vec nëse AK kërkon të marrë produkte të vjetra dhe jo të reja*," Komisioni i Prokurimit Publik referuar kthim përgjigjes Nr. 2999/8 prot datë 03.12.2019 të autoritetit konteraktor konstaton se autoriteti kontraktor e ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit konkretisht "*Në lidhje me Sistemin Operativ kërkesa juaj për të hequr versionin "Ëindoës XP", gjykohet si e drejtë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave".*

III.5.1. Sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontrktor duhet të bëjë modifikimin e specifikimit teknik dhe të publikojë shtojcën në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit […]"Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.*

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "*Luar Bros*" sh.p.k për procedurën e prokurimit *"Kërkesë për Propozim",* me Nr. *REF- 43803-11-18-*

2019, me objekt "*Blerje Peshore Elektronike*", me fond limit 3,175,000 lekë pa tvsh, publikuar më datë 19.11.2019 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "*Luar Bros*" shpk..
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1866 Protokolli, Datë 11.12.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar	**Anëtar**	**Anëtar**
Enkeleda Bega	**Vilma Zhupaj**	**Merita Zeqaj**

Kryetar
Evis Shurdha